



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 në lidhje me nenit 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), si dhe nenin 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (tekst i pastruar), duke vepruar për denoncimin në seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021 morri

VENDIM

Konstatohet gjendja e konfliktit të interesave, tek personi – anëtar i Këshillit të Komunës dhe anëtar i Këshillit të shkollës SHFK, për arsye që ajo është në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 4 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, ky Vendim dorëzohet derit tek i emëruari për informim dhe veprim në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi të menjanon konfliktin e interesave, gjegjësisht të jep dorëheqje në njëren nga këto dy funksione të cilat i kryen.

SQARIM

Lënda me numër 09-4341/1 nga viti 2019 është formuar në bazë të Ankesës nga parashtrues i njohur me akuza ndaj personit i cili është anëtar i Këshillit të Komunës njëkohësisht është edhe anëtar i këshillit të shkollës në SHFK edhe përkaj dispozitave ligjore për **mospërputhje (mosbashkim)** të funksionit anëtar i këshillit dhe funksion tjetër të cilët i zgjedh dhe i emëron vetqeverisja lokale.

Me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike dhe vërtetimit të besueshmërisë së akuzave, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek Komuna me kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve dhe nga komuna ka kërkuar të dhëna se vallë personi është i emëruar në këshillin e shkollës së SHFK dhe nëse po, në shtojcë të dorëzohet vendimi për emërim.

Në afatin e caktuar me ligj, Komuna deri tek Komisioni shtetëror dërozoj përgjigje për Kërkesën dhe në shtojcë Vendimin për shkarkim dhe emërim të anëtarëve të këshillit të shkollës SHFK me datë 23.03.2018, nga e cila mund të vërehet se në seancën e Këshillit të Komunës të mbajtur me datë 15.03.2018 **është miratuar vendim të caktohet anëtar i këshillit të shkollës**

Nga ana tjetër, Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave e parashih këtë:

(1) Person i zgjedhur ose i emëruar gjatë kohës derisa zgjat mandati i tij është i obliguar t'i respekton rregullat për mosbashkim të funksionit të cilën e kryen me funksion tjetër ose veprime të përcaktuara në Kushtetutën dhe ligjet.

(2) *Person i zgjedhur ose i emëruar nuk mund njëkohësisht të kryen funksion të personit përgjegjës ose anëtar i organit për menaxhim ose organ mbikqyrës në ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik i cili disponon me kapital shtetëror.*

Duke pas parasyshë të shënuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në seancën e 46 përfundoi se në rastin konkret **janë vërtetuar akuzat në Ankesë kundër personit, gjegjësisht vërtetohet ekzistimi i gjendjes së konfliktit të interesave.**

Në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të ininteresave ky Vendim të dorëzohet edhe deri tek anëtar i Këshilli të komunës dhe anëtar i këshilli të shkollës SHFK me të cilën vërtetohet shkelje të dispozitave nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, në mënyrë që në afat prej 15 ditë nga dorëzimi i vendimit të jep dorëheqje nga njëri prej dy funksioneve të cilat i kryen njëkohësisht dhe për të njëjtën ta informon Komisionin shtetëror me dorëzimin e dëshmimeve për të njëjtën.

Këshillë juridike: kundër këtij vendimi mund të ngritet mosmarrveshje administrative pranë Gjykatës administrative në afat prej 30 ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROK PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**

Përpunoi: m-r E. N., këshilltarë
Miratoi: K. N., anëtar i KSHPK